

REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

INSTITUCIONI KOMBËTAR ANSAMBLI I KËNGËVE E VALLEVE POPULLORE SHQIPTARE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT

Në bazë të nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 62/05 267/20), neni 77-d i Ligjit për Kulturë (Gazeta Zyrtare e Republika e Maqedonisë nr. 31/98, 49/03, 82/05, 24/07, 116/10, 47/11, 51/11, 136/12, 23/13, 187/13, 44/14, 61/15, 154/15, 39/16, 11/18 dhe 11/18), Neni 20-g të Ligjit për punësuarit në sektorin publik (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë Nr. 27/14, 199/14, 27 / 16, 35/18, 198/18 dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 143/19 dhe 14/20), neni 4 i Rregullores për formën dhe përmbajtjen e shpalljes publike dhe fletëparaqitjes për punësim, mënyrës së kryerjes së procedurës së punësimit, mënyrës së zbatimit të intervistës, si dhe mënyrës së ndarjes së pikëve në varësi të kategorisë dhe nivelit të punës për të cilat është shpallur konkursi publik në Institucionin Kombëtar nr. 0201-61/02 më 23.01.2020 dhe Vendimit të marrë nga personi udhëheqës i Institucionit Kombëtar për botimin e shpalljes publike, Institucionit Kombëtar Ansambli I këngëve dhe valleve popullore shqiptare në Republikën e Maqedonisë së Veriut - Shkupi shpall:

SHPLLJE PUBLIKE Nr. 1/2021

për punësimin e dy (2) personave në kohë të caktuar pune për periudhë deri në 5 vite

IN Ansambli I këngëve dhe valleve popullore shqiptare në Republikën e Maqedonisë së Veriut - Shkup, ka nevojë për punësim në kohë të caktuar për periudhë kohore deri në 5 vite të dy (2) realizuesve, dhënës të shërbimeve publike në kulturë - Kategoria A - Artistë , Artistë të Nivelit A5 - grupi i tretë, në pozicionet vijuese:

1. Shifra **KUL 03 04 A05 013** artist i grupit të tretë – **Muzicent instrumentalist Harmonikë** - 1 (një) realizues;
2. Shifra **KUL 03 04 A05 013** artist i grupit të tretë **Këngëtar** - 1 (një) realizues;

Kandidatët e interesuar duhet të plotësojnë:

Kushtet e përgjithshme:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- Të jetë i moshës madhore;
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës dhe
- Me vendim të plotëfuqishëm gjyqësorë të mos i jetë shqiptuar dënim, ndalesë për kryerjen e profesionit, veprimtarisë apo detyrës

Kushtet e veçanta:

- Të ketë kualifikimet e duhura profesionale të nevojshme për vendin e punës;
- Të ketë përvojën e nevojshme të punës që kërkohet për vendin e punës dhe
- Të ketë kompetenca tjera të posaçme të punës të nevojshme për vendin e punës në qoftë se kërkohet.

- **Pozicioni i punës nën pikën 1:**

- **Kushte të veçanta: Niveli dhe lloji i arsimit:** Kandidati duhet të ketë arsim të lartë së paku 240 kredite të arritura sipas ECTS ose të ketë të kryer shkallën VII/1 të Arteve Muzikore ose të ketë të përfunduar shkollën e mesme të (muzikës ose gjimnazin e përgjithshëm). Përvoja e punës: Deri në një vit përvojë pune;

VËREJTJE: Punësimet e parapara sipas Balancerit në përputhje me Planin vjetor të punësimeve në institucion për vitin 2021 janë: Maqedonas(e), 1 realizues.

Rroga neto në vlerë: 32.791,00 denarë;

- **Vendi i punës nën pikën 2:**

- **Kushtet e veçanta: Niveli dhe lloji i arsimit:** Kandidati duhet të ketë arsim të lartë së paku 240 kredite të arritura sipas ECTS ose të ketë të kryer shkallën VII/1 të Arteve Muzikore ose të ketë të përfunduar shkollën e mesme të (muzikës ose gjimnazin e përgjithshëm). Përvoja e punës. Deri në një vit përvojë pune.

VËREJTJE: Punësimet e parapara sipas Balancerit në përputhje me Planin vjetor të punësimeve në institucion për vitin 2021 janë: Maqedonas(e), 1 realizues.

Rroga neto në vlerë: 32.791,00 denarë

Përshkrimi i orarit të punës:

Orari ditor i punës është në kohëzgjatje prej 8 orësh në ditë – në përputhje me nevojat e programit të provave dhe shfaqjeve, respektivisht në ndrrime për deri sa orari javor i punës është në kohëzgjatje prej 40 orëve në javë.

Kandidatët për punësim paraqiten në shpalljen publike nëpërmjet plotësimit të fletëparaqitjes dhe bashkangjitjes së dëshmimeve për plotësimin e kushteve për vendin e punës. Fletëparaqitjen për punësim kandidatët mund ta marrin nga Arkiva e IN Ansambli i këngëve dhe valleve popullore shqiptare në Republikën e Maqedonisë së Veriut – Shkup ose në veb faqen e Institucionit: www.ansambli-shqiptar.mk

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentet vijuese për plotësimin e **kushteve të përgjithshme** për vendin e punës në formë origjinale ose në kopje të vërtetuar në noter edhe atë:

- **Dëshmi për shtetësinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut - (jo më e vjetër se gjashtë muaj);**

- **Dëshmi për aftësinë e përgjithshme shëndetësore për vendin e punës - (jo më e vjetër se gjashtë muaj);**

- **Vërtetim / Certifikatë që nuk ka ndalesë për të kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës (jo më të vjetër se gjashtë muaj)**

-**Fletëparaqitje e plotësuar për punësim;**

- **Biografia e shkurtër;**

- **Letër e shkurtër motivuese;**

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentet vijuese për plotësimin e **kushteve të veçanta** për vendin e punës në formë origjinale ose në kopje të vërtetuar në noter edhe atë:

- **Diplomë / certifikatë për arsimin e përfunduar;**

-**Dëshmi për përvojë pune -për vendin e punës ku është paraparë;**

Shpallja publike për pozicionet e punës nga pikat 1 dhe 2 zgjat 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e shpalljes së njoftimit në faqen e internetit të Institucionit Kombëtar dhe në tre gazeta ditore, nga të cilat njëra është në gjuhën që flasin më së paku 20% e qytetarëve të cilët flasin gjuhë tjetër zyrtare nga gjuha maqedonase.

Procedura e përzgjedhjes përbëhet nga seleksionimi administrative për kontroll të besueshmërisë së të dhënave të parashtruara dhe dëshmimeve të dorëzuara për

shpalljen publike nga ana e Komisionit për zbatimin e procedurës së punësimit dhe zbatimin e procedurës së audicionit.

Kandidatët, fletëparaqitjen e plotësuar saktë dhe me të dhëna të sakta me dokumentet e nevojshme I dorëzojnë deri tek Arkiva e IN Ansambli i këngëve dhe valleve popullore shqiptare në Republikën e Maqedonisë së Veriut – Shkup çdo ditë pune prej orës 08:30 deri 16:00 në adresën vijuese: IN Ansambli i këngëve dhe valleve popullore shqiptare në Republikën e Maqedonisë së Veriut-Shkup Bul.Shën Kirili dhe Metodij nr.54 – Shkup, ndërtesa Nova Makedonija, kati 3 – të, zyra nr.327 me shënim: Për Konkursin nr.1/2021.

Kandidatët e paraqitur në shpalljen publike, do të informohen për kohën dhe vendin e mbajtjes të secilës fazë vijuese të procedurës së përzgjedhjes nga ana e Komisionit për zbatimin e procedurës së punësimit:

- Faza 1: Seleksionimi administrative – kontroll i të dhënave të parashtruara në fletëparaqitje me kushtet e parapara në konkurs dhe kontroll I dëshmime të bashkangjitura.
- Faza 2: Audicioni – kontrolli i aftësive artistike të kandidatit në bazë të Programit për verifikimin e aftësive artistike të kandidatit, në përputhje me Rregulloren për audicion në IN Ansambli I këngëve dhe valleve popullore shqiptare në Republikën e Maqedonisë së Veriut- Shkup nr.0201-140 nga 06.06.2019 – të.

Programi për kontrollimin e aftësive artistike të kandidatit do të publikohet në web faqen e IN Ansambli I këngëve dhe valleve popullore shqiptare në Republikën e Maqedonisë së Veriut- Shkup, në të njëjtën kohë me shpalljen e publike, me qëllim që të njoftohen kandidatët e interesuar me përmbajtjen e së njëjtës.

Për ditën, orën dhe vendin e mbajtjes së audicionit, me qëllim të kontrollit të aftësive artistike të kandidatit, kandidatët do të informohen me njoftim publik për ditën, orën dhe vendin e mbajtjes së audicionit nëpërmjet web faqes së institucionit si dhe nëpërmjet telefonit që do e lënë në fletëparaqitje dhe në mënyrë elektronike (e-mail) në përputhje me të dhënat që do ti vendosin në fletëparaqitjen për punësim.

Në qoftë se në shpalljen publike paraqiten deri në 200 kandidatë për një vend pune, përzgjedhja do të bëhet në afat prej 45 ditëve, prej 201 deri 500 kandidatë për një vend pune përzgjedhja do bëhet në afat prej 90 ditëve dhe mbi 500 kandidatë për një vend pune përzgjedhja do bëhet në afat prej 120 ditëve, pas skadimit të afatit për paraqitje në konkurs.

Kandidatët janë të detyruar që me përgjegjësi të plotë materijale dhe penale të konfirmojnë se të dhënat në fletëparaqitje janë të sakta, ndërsa dëshmit e dorëzuara janë vërtet në formë origjinale.

Të drejtë pjesmarrjeje kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Maqedonisë së Veriut të cilët I plotësojnë kushtet për aplikim. Kushtet e paraqitura në konkurs,kandidatët duhet ti plotësojnë në momentin e paraqitjes.

Aplikimet e vonuara nuk do të merren parasysh.

IN „Ansambl i këngëve dhe valleve popullore shqiptare në Republikën e Maqedonisë së Veriut“ – Shkup.

